



HERITAGE & CO'

CHwB Albania, e angazhuar për ruajtjen e trashëgimisë kulturore e kuptuar si një burim ekonomik, kulturor dhe shoqëror, ka zhvilluar projekte dhe aktivitete të shumta të trashëgimisë në të gjithë Shqipërinë dhe Ballkanin, që synojnë promovimin e vlerave të tilla si dialogu, mirëkuptimi dhe respektimi i ndërsjellë. Për këtë qëllim, projektet janë hartuar të jenë gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse, duke kërkuar angazhimin aktiv të komunitetit lokal, përfshirë përfshirjen e vullnetarëve.

Bashkëpunimi me vullnetarë vendas dhe ndërkombëtarë ka qenë pjesë e traditës së organizatës që nga viti 2007, veçanërisht përmes Kampeve Rajonale të Restaurimit (RRC), Atelierëve të Trashëgimisë si dhe Projektimin dhe Fuqizimin e Komuniteteve dhe Trashëgimisë, etj. Nga kjo përvojë e pasur, programi i ynë i ri Heritage & Co' është një vazhdim i këtij bashkëpunimi të frytshëm dhe synon të zgjerojë fushën e vullnetarëve duke ofruar mundësinë për t'u përfshirë në aktivitete të ndryshme të lidhura me trashëgiminë.

VIZIONI YNË

Të udhëhequr nga dëshira për të afruar më pranë komunitetet dhe trashëgiminë, si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale, ne besojmë se vullnetarët, si agentë të komuniteteve të tyre, kanë më shumë mundësi të rrisin ndërgjegjësimin për trashëgiminë lokale në mënyrën e tyre. Ne e shohim vullnetarizmin e trashëgimisë si një nga çelësat për të gjallëruar kuptimin dhe vlerën e trashëgimisë lokale në kushtet e një përvojë pasuruese personale dhe njerëzore që ne kemi. Duke mbështetur nivelin e identifikimit të trashëgimisë, vullnetarizmi është një garanci e çmuar për të siguruar qëndrueshmërinë e saj.

FORMATI I VULLNETARIZMIT

Heritage & Co' synon ndërtimin e një rrjeti vullnetarësh për të mbështetur aktivitetet e organizatës në bashkëpunim me aktorë kulturorë dhe arsimorë. Në terma konkretë, është një angazhim afatgjatë ose afatshkurtër ku vullnetarët do të thirren për misione specifike dhe të rastiit (mesatarisht 1 orë 30 minuta, 2 orë për aktivitet / mision) sipas aftësive dhe interesave të tyre, dhe duke marrë parasysh disponueshmëria e tyre. Qëllimi është që të përputhen nevojat specifike për zbatimin e një aktiviteti si dhe aspiratat personale dhe afësitë e vullnetarëve lokalë.



Në mënyrë që të sigurojmë suksesin e misionit të tyre, ne do t'u sigurojmë vullnetarëve mjetet për të kryer misionin duke i shoqëruar dhe trajnuar ata përmes punëtorive. Si përfundim, vullnetarët që marrin pjesë në program do të rimbursohen për shpenzimet e bëra gjatë misionit vullnetar dhe do të marrin pagesën e një shume simbolike për mbështetjen e tyre të vlefshme.

PËR KË?

Ky program është i hapur për të gjithë, profesionistët ose entuziastët e trashëgimisë, pavarësisht nga mosha ose prejardhja. Jemi duke kërkuar për çdo talent për të sjellë impaktin e tyre në këtë projekt kolektiv.

LLOJI I AKTIVITETIT

Vullnetari do të jetë në gjendje të përfshihet në disa aktivitete që synojnë një publik të larmishëm, si fëmijë ashtu edhe të rritur, vendas ose ndërkombëtarë. Mund të përfshijë pjesëmarrjen në animacionin e Atelievëve të Trashëgimisë për një audiencë të re, dokumentimin e veprimtarive, ndërmjetësimin kulturor dhe të trashëgimisë, turne udhëzuese, mbështetje për koordinimin e një aktiviteti, ose ndonjë aktivitet tjetër të trashëgimisë që përcaktohet bashkarisht.

PUNOJMË SË BASHKU / MBËSHTESIM NJËRI-TJETRIN

Heritage & Co' është hartuar që të pasurohet në mënyrë të ndërsjelltë dhe për të sjellë vlerë të shtuar për të gjitha palët e përfshira.

PËR VULLNETARËT

- Përvetëson njohuri dhe përvojë praktike në sfera të ndryshme profesionale në lidhje me trashëgiminë kulturore
- Bëhen pjesë e një rrjeti frymëzues të praktikuesve dhe entuziastëve të trashëgimisë në të gjithë Shqipërinë dhe rajonin, për të lehtësuar shkëmbimin e përvojave dhe praktikave, ideve dhe iniciativave.
- Zbaton dhe përmirëson aftësitë personale përmes arsimit joformal
- Lehtësim i integritit shoqëror dhe profesional të njerëzve të motivuar dhe të përkushtuar në shoqëri
- Përjeton një shkëmbim të pasur njerëzor përmes kontaktit me vendas dhe ndërkombëtarë në Shqipëri dhe më gjerë

PËR KOMUNITETIN LOKAL

- Përfitim nga ringjallja e jetës kulturore dhe trashëgimisë lokale
- Ka mundësinë të thellojë kuptimin e mjedisit të saj kulturor dhe historik

- Merr informacione teknike të kuptueshme dhe të përshtatshme përmes vullnetarit duke qenë ndërmjetës midis profesionistëve dhe banorëve

PËR CHWB ALBANIA DHE PARTNERËT

- Shpërndarja e aktiviteteve të lidhura me trashëgiminë në lokalitete të ndryshme dhe po ashtu në komunitete
- Merr mbështetjen e vullnetarëve frymëzues dhe të shkathët, duke lehtësuar zhvillimin dhe zbatimin e aktiviteteve të trashëgimisë.
- Përfiton nga rigjallërimi i aktiviteteve

SI TË MARRIM PJESË?

Për të qenë pjesë e programit, ju ftojmë të plotësoni formularin e aplikimit të disponueshëm në faqen tonë të internetit (chwb.org/albania/). Kjo do të na lejojë të njohim profilet e secilit vullnetar në mënyrë që të përcaktojmë pritshmëritë e tyre dhe t'i përmbushim ato sa më saktë që të jetë e mundur. Kështu, sa më i saktë të jetë formulari i aplikimit, aq më mirë do të jemi në gjendje të plotësojmë dëshirat e të gjithëve.